

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS**

**BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**



**Programi mësimor**

**Arsimi figurativ  
për klasën VII**

**Shkup, 2023**

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<b>Arsimi figurativ</b>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	VII (e shtatë)
Temat/fusha në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Gjuha figurative</b></li> <li>• <b>Arti dydimensional</b></li> <li>• <b>Arti tredimensional</b></li> </ul>
Numri i orëve	1 orë në javë/36 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompjuter, tablet, projektor, aparat fotografik digjital, celular (aplikacione), tabelë e mençur, printer, etj.</li> <li>• Interneti dhe softueri arsimor.</li> <li>• Letër, laps (B dhe HB), qymyr, ngjyra druri, tush dhe pendë, pastel i thatë, flomastera, brusha, ngjyra tempera, ngjyra akrilike, ngjyra uji, gvash, markera, ngjitës, gërshërë, gjips, matricë, karton, pendla, mjet rrafshues (trup cilindrik), rakel.</li> <li>• Sapun, dyllë, letër alumini, plastikë, ambalazh, tela, pëlhurë, lesh, litar, ngjitës druri, shpatulla, kapëse.</li> <li>• Riprodhime të veprave të artit, punimeve të nxënësve, fotografive, revistave, librave, produkteve të dizajnit etj.</li> </ul>
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Lëndën e Arsimit figurative në klasën e shtatë mund zbatojë person i cili ka mbaruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• studimet në artet figurative, drejtimi mësimor, VII/1 ose VI A (sipas KMK) dhe 240 SETK;</li> <li>• Studimet në artet figurative, drejtimet tjera jomësimore, VII/1 ose VI A (sipas KMK) dhe 240 SETK dhe përvetësimi i përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodologjike në një institucion të arsimit të lartë të akredituar.</li> </ul>

Rezultatet e të mësuarit të theksuara në programin mësimor shpijnë në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira nga fusha **Shprehja dhe kultura artistike** nga Standardet kombëtare:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>	
VIII-A.3	të shpreh idetë, përvojat dhe emocionet e veta, duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive);
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e ngushtë e më të gjerë dhe të analizojë lidhjen dhe ndërvarësinë e tyre;
VIII-A.9	të njohë dhe shpjegojë se si kultura së cilës i përket (përfshirë traditën dhe fenë) ka ndikuar në formimin e identitetit dhe botëkuptimit të tij/saj;
VIII-A.11	të njohë praninë e etnocentrizmit dhe të identifikojë elementet në kulturë që kontribuojnë në manifestimin e tij;
VIII-A.12	të interpretojë botën jo vetëm nga këndvështrimi i pjesëtarëve të kulturës së tyre, por edhe nga perspektiva e kulturave të tjera.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.1	arti dhe forma të tjera të shprehjes kulturore kontribuojnë në kuptimin dhe ndryshimin e botës;
VIII-B.3	respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor.

Programi mësimor përfshin gjithashtu kompetencat relevante nga fushat e mëposhtme transversale të Standardeve Kombëtare:

### ***Njohuri gjuhësore***

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>	
I-A.1	të shprehë dhe të përcjellë mendimet, ndjenjat, informacionet dhe qëndrimet e tij në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e tij amtare përmes mediave të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	të njohë dhe të përdorë forma të ndryshme e të shprehurit me shkrim: letrare (poemë, tregim të shkurtë, prezantim/fjalim, ese letrare, ditar etj.) dhe joletrare (ese tematike, raport, kërkesë, njoftim, reklamë etj.);
I-A.3	të udhëheqë një dialog kritik dhe konstruktiv, duke i shprehur pikëpamjet e tij në mënyrë argumentuese;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë në gjendje të nxjerrë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;

I-A.11	të identifikojë dhe analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit të vet mund të kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e komunikimit, por edhe të shkaktojnë keqkuptime dhe konflikte.

### **Matematika dhe shkencat natyrore**

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>
III-A.51	të shpjegojë ndërveprimin midis njeriut dhe mjedisit jetësor dhe të identifikojë ndikimet pozitive dhe negative të njeriut në mjedisin jetësor ;
III-A.52	të kuptojë rëndësinë dhe nevojën për zhvillim të qëndrueshëm dhe të analizojë në mënyrë kritike situatat në të cilat ka konflikt interesi ndërmjet nevojës për zhvillim ekonomik-teknologjik dhe mbrojtjes së mjedisit;
III-A.53	të analizojë marrëdhëniet ndërmjet sistemeve ekologjike, sociale dhe ekonomike nga niveli lokal në atë global.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
III-B.8	çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjerë dhe se duhet të zhvillojë ndërgjegjësimin ekologjik dhe të veprojë në drejtim të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor.
III-B.9	duhet të kuptojë përparësitë, kufizimet dhe rreziqet e teorive shkencore dhe zbatimin e tyre dhe të tregojë një qëndrim të zhvilluar ndaj marrjes së vendimeve të sakta dhe ndërtimit të vlerave, duke përfshirë edhe aspektin moral në zgjidhjen e problemeve.

### **Shkrim-leximi digjital**

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>
IV-A.1	të hulumtojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, përzgjedhë dhe përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe situatë konkrete;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët për të analizuar një problem, për të zhvilluar një ide dhe një plan për kërkimin dhe zgjidhjen e tij dhe për të planifikuar kur dhe për çfarë të përdoret TIK;

IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, të analizojë të dhënat dhe t'i prezantojë ato në mënyra të ndryshme, duke respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.8	të përdorë përmbajtjen digjitale, rrjetet arsimore dhe sociale dhe retë digjitale në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme – lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;
IV-B.5	Informacionet e disponueshme në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve.

### **Zhvillimi personal dhe social**

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>
V-A.4	të vlerësojë aftësitë dhe arritjet e veta (duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe, në bazë të kësaj, të përcaktojë përparësitë që do të mundësojnë zhvillimin dhe përparimin e tij/saj;
V-A.6	të vendosë synime për mësimin dhe zhvillimin personal dhe të punojë në tejkalimin e sfidave që dalin në rrugën drejt realizimit të tyre;
V-A.8	të organizojë kohën e tij/saj në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj të arrijë në mënyrë efikase dhe efektive qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.10	të zbatojë parimet etike kur vlerëson të drejtën dhe të gabuarën në veprimet e veta dhe të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtytshme të karakterit (siç janë: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat veta në mënyrë konstruktive;
V-A.17	të kërkojë reagime dhe mbështetje për veten, por edhe për të dhënë reagime dhe mbështetje konstruktive në dobi të të tjerëve;

V-A.18	të hulumtojë, duke bërë pyetje përkatëse për të zbuluar problemet, për të analizuar dhe vlerësuar informacionet dhe sugjerimet dhe për të kontrolluar supozimet.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
V-B.4	çdo veprim që ai/ajo ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ai/ajo ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve të përmbushin interesat dhe nevojat e tij/saj, po ashtu ai/ajo ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informatës kthyesë dhe pranimi i kritikave konstruktive çojnë në përparimin personal në nivel individual dhe shoqëror.

### **Shoqëria dhe kultura demokratike**

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>
VI-A.2	të analizojë sjelljen e tij për të përmirësuar, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;
VI-A.4	të reflektojë në mënyrë kritike për vlerat dhe sjelljet e ndryshme personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (veçanërisht në situata të ndjeshme etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranuar nga shoqëria, por edhe t'i sfidojë ato kur mendon se është e nevojshme;
VI-A.8	të shohë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.13	të analizojë konceptin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, të identifikojë rastet e shkeljes së të drejtave dhe të marrë masa për respektimin pa kriter të tyre;
VI-A.17	të analizojnë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe të zgjedhin burime të besueshme informacioni mbi të cilat do të bazojnë pikëpamjet e tyre;
VI-A.19	të shpjegojë rëndësinë e proceseve demokratike në shoqëri dhe të zbatojë parimet e pjesëmarrjes demokratike brenda shkollës;

VI-A.27	të tregojë dhe të shpjegojë historinë (sociale, kulturore dhe politike) të popullit të vet dhe historitë e popujve të tjerë që jetojnë në vendin tonë dhe në rajon, me veçoritë e tyre dhe në kontekstin e së kaluarës së përbashkët historike.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
VI-B.1	Njohja e identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimit personal;
VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë thelbësore për arritjen e interesit të përbashkët publik;
VI-B.9	çdo qytetar duhet të marrë përgjegjësinë për ndryshimet në natyrë të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore;
VI-B.10	njohja e historisë dhe gjeografisë lejon një kuptim më të mirë të botës në të cilën jetojmë.

#### **Teknika, teknologjia dhe sipërmarrja**

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është në gjendje:</i>
VII-A.6	të zhvillojë një plan për të bërë një produkt me vlerë të dobishme, të prodhojë produktin duke përdorur materiale, mjete dhe procedura të përshtatshme dhe të kontrollojë funksionalitetin e tij;
VII-A.7	të përcaktojë çmimin e produkteve, duke përfshirë fitimet, kostot dhe detyrimet.
	<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>
VI-B.2	idetë e suksesshme që çojnë në përfitime personale, sociale dhe financiare janë rezultat i kreativitetit, iniciativës, përkushtimit dhe këmbënguljes;
VI-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe qëndrimi ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune;
VII-B.5	burimet nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi.

Tema: **GJUHA ARTISTIKE**

Orët e përgjithshme: 4

**Rezultatet e mësimit:**

Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë:

1. të dallojë artin dydimensional dhe atë tredimensional dhe të përdorë gjuhën e artit gjatë përshkrimit të fushave të artit;
2. të përshkruajë elementet e artit dhe parimet e artit për çdo fushë të artit;
3. të përdorë gjuhën e figurative gjatë përshkrimit të veprave artistike.

**Përmbajtjet (dhe nocionet):**

- **Fushat e artit**  
(gjuha artistike, arti dydimensional, vizatimi, piktura, grafika, dizajni dhe komunikimet vizuale në 2D, arti tredimensional, skulptura, dizajni dhe komunikimet vizuale në 3D)

- **Elementet dhe parimet e artit**  
(Vija dhe vlerat e vijave, drejtimi, toni dhe shkalla tonike, valerin, harmonia, kontrasti, hapësira, ritmi, stilizimi, zbukurimi)

- **Vlerësimi estetik**  
(motivi, ideja, teknika)

**Standardet e vlerësimit:**

- Dallon artin dydimensional (vizatim, pikturë, grafikë dhe dizajn dhe komunikime vizuale në 2D) nga arti tredimensional (skulpturë dhe dizajn dhe komunikime vizuale në 3D).
- Përdor gjuhën artistike kur përshkruan fushat artistike (vizatim, pikturë, grafikë, skulpturë, dizajn dhe komunikime vizuale).
- Përshkruan elementet e artit dhe parimet e artit: vlerat e vijës dhe linjës, drejtimin, tonin dhe shkallën tonike, valerin, harmoninë, kontrastin, hapësirën dhe ritmin, stilizimin, zbukurimin për çdo fushë arti.
- Përshkruan një vepër artistike (motiv, ide dhe teknikë) duke përdorur gjuhën artistike.

**Shembuj aktivitetesth**

- Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, bëjnë postera që ilustrojnë ndarjen e fushave të artit brenda artit dydimensional dhe tredimensional. Më pas ua prezantojnë posterat shokëve të klasës.
- Nxënësit krijojnë material ndihmës rreth elementeve të artit dhe parimeve të artit (vija dhe llojet e vijave, kahe, toni dhe shkalla tonike-valer, harmonia, kontrasti, hapësira dhe ritmi) për çdo fushë arti.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, shikojnë vepra nga muzetë e botës, ku secili grup zgjedh një muze nga i cili do të përzgjedhë veprat. Më pas analizon veprat përmes motivit, idesë, teknikës dhe elementeve artistike dhe i përshkruan ato duke përdorur gjuhën artistike. Në fund, secili grup bën një prezantim (në letër ose në mënyrë digjitale) me temën: Muzetë në mbarë botën dhe ua prezanton atë shokëve të klasës.

Tema: **ARTI DYDIMENSIONAL**

Orët e përgjithshme: 24

**Rezultatet e mësimit:**

Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë:



1. të dallojë dhe të zbatojë vlera të ndryshme vijash, drejtime dhe dendësi vijash, të kombinojë vija, tone, tekstura/struktura të ndryshme duke aplikuar teknika të ndryshme të vizatimit;
2. të dallojë shkallët tonike akromatike nga ato kromatike, ngjyrat e ngrohta nga të ftohta, harmoninë nga kontrasti, kompozicionin figurativ nga jofigurativ dhe të zbatojë e të përvetësojë teknikat e ndryshme të pikturës kur pikturohet nga kujtesa dhe nga imagjinata e vet;
3. të dallojë tonet akromatike dhe kontrastin dritë-errësirë në veprat grafike dhe të zbatojë teknika dhe procedura të ndryshme grafike;
4. të dallojë produktet nga dizajni grafik dhe të krijojë zgjidhje konceptuale dhe produkte nga dizajni grafik me motive të dhëna dhe sipas idesë së vet.

Nxënësi/nxënësja do të:

1. zhvillojë imagjinatën dhe kreativitetin gjatë krijimit të veprave artistike (figurative);
2. zhvillojë aftësinë për vlerësimin estetik të veprave artistike dhe të krijimeve të nxënësve.

**Përmbajtjet (dhe nocionet):**

**Standardet e vlerësimit:**

- **Vizatimi dhe teknikat e vizatimit**  
(vija, vlerat e vijave, tekstura, toni, teknika e vizatimit, sipërfaqja, intensiteti, teksturë/strukturë, konturë, formë, pastel)

- Dallon vlerat e vijave dhe dendësitë e vijave në hapësirën natyrore.
- Krijon një kompozim duke kombinuar vijat, dendësinë e vijave, teksturat, vlerat tonike dhe përmasat.
- Zbaton vijat në drejtime, dendësi dhe intensitet të ndryshëm (teksturë) duke përfutur vlera tonike të ndryshme.
- Aplikon vlerat e vijave dhe procedurat e ndryshme nëpërmjet teknikës pastel.
- Interpretin kuptimin e krijimit të vet – vizatimit.
- Përdor programe kompjuterike grafike për të vizatuar një vizatim bazuar në një fotografi.

- **Pikturimi dhe teknikat e pikturimit**  
(toni, shkallët tonike, valer, ngjyrat kromatike dhe akromatike, ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta, harmonia dhe kontrasti i ngjyrave, kontrasti komplementar, portreti, autoportreti, shprehje figurative, shprehje jo figurative, format abstrakte)

- Njeh tonin/ valerën në një vepër artistike/puna e nxënësve.
- Dallon shkallën tonike akromatike nga ajo kromatike dhe përdor shkallën tonike të ngjyrave në një vizatim.
- Dalloni ngjyrat e ngrohta dhe ato të ftohta.
- Aplikon ngjyra të ngrohta/të ftohta.
- Dallon harmoninë nga kontrasti i ngjyrave.
- Aplikon harmoninë duke kombinuar ngjyrat.
- Përdor programe kompjuterike grafike për të krijuar një vizatim me kontrast plotësues.
- Përdor shprehje figurative dhe jofigurative.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor forma abstrakte kur pikturon sipas imagjinatës së tij.</li> <li>• Interpreton kuptimin/simbolizmin e pikturës së vet abstrakte.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Grafika dhe teknikat grafike</b> (kontrasti, tonet akromatike, gravurë në gjips, kaligrafisë, tekstura, vulë e lartë, vulë e thellë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon tonet akromatike dhe kontrastin dritë-errësirë.</li> <li>• Krijon punë grafike me kontrast dritë-errësim (lineare dhe të sheshta).</li> <li>• Zbaton teknikën e vulës së lartë (me matricë në gravurë në gjips) për të prodhuar gjurmë grafike.</li> <li>• Zbaton teknikën grafike të kaligrafisë për të krijuar gjurmë grafike (vulë e lartë/e thellë ose kombinim).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dizajni dhe komunikimet vizuale në 2D</b> (dizajni grafik, dizajni i librit, kopertinës, ilustrimi, fletushkë, banderole, tekst, ornament, stilizimi, ritmi)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon produktet nga fusha e dizajnit grafik: dizajni i librit, fletushkave dhe banderolë.</li> <li>• Aplikon ornament në punën e tij.</li> <li>• Krijon zgjidhje ideore për kopertinë dhe ilustrim.</li> <li>• Interpreton kuptimin dhe mesazhin e veprës së tij.</li> <li>• Përdor programe kompjuterike grafike për të krijuar një zgjidhje ideore për një fletushkë ose banderolë.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit perceptojnë dhe njohin vlerat e vijave dhe dendësinë e vijave të shtresave gjeologjike dhe dukurive të tjera natyrore (nëpërmjet vëzhgimit në natyrë ose përmes fotografisë dhe mjeteve të tjera vizuale) dhe vizatojnë duke kombinuar teknikat e lapsit, qymyrit dhe flomasterit.</li> <li>• Nxënësit vizatojnë në mënyrë akromatike një motiv Natyra e vdekur, duke shprehur shkallëzimin e tonit dhe kontrastin dritë-errësim me qymyr.</li> <li>• Nxënësit vizatojnë motive nga një mjedis urban dhe tregojnë sipërfaqet me vlera tonike të ndryshme dhe përdorin vija me intensitet të ndryshëm dhe ndërthurje (teksturë/strukturë) duke përdorur teknika të ndryshme vizatimi (laps, tush, flomaster).</li> <li>• Nxënësit vizatojnë një temë të lirë duke aplikuar lloje të ndryshme vijash dhe tonesh në një ngjyrë në teknikën pastel. Në të njëjtën kohë, ata hulumtojnë procedurat për marrjen e vlerave të vijave duke fshirë me një leckë, pambuk, gome etj. Pastaj ata interpretojnë kuptimin e krijimit të tyre.</li> <li>• Nxënësit zgjedhin individualisht një foto. Me ndihmën e programeve kompjuterike grafike vizatojnë konturet e formave në kompozicion dhe më pas mbushin sipërfaqet me teksturë të ndryshme (sipas shembullit të Roj Lihtenshtajn).</li> <li>• Nxënësit identifikojnë dhe krahasojnë tonet/valeret në veprat e artistëve të famshëm (Pol Kle, Viktor Vazarelli) ose veprat e nxënësve.</li> </ul>	

- Nxënësit rishikojnë shkallët tonike dhe dallojnë shkallët tonike akromatike nga ato kromatike të ngjyrave. Më pas, duke përdorur shkallë të ndryshme tonesh, vizatojnë një peizazh nga kujtesa, në një motiv: Mugra, Kveçerina, Zalez etj., duke përdorur ngjyra tempera, ngjyra uji ose teknikë me gvash.
- Nxënësit dallojnë ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta në rrethin e ngjyrave. Më pas, dallojnë ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta në mjedis (në klasë, në oborr të shkollës etj.).
- Nxënësit të ndarë në dyshe zgjedhin një kompozim të një artisti të njohur. Më pas njëri nxënës vizaton kompozimin me ngjyra të ngrohta, kurse tjetri të njëjtën përbërje me ngjyra të ftohta (me tempera ose ngjyra akrilike). Më pas dyshet prezantojnë kompozimet para klasës dhe të gjithë së bashku ndajnë përshtypjet që lënë mbi to ngjyrat e ngrohta/të ftohta.
- Nxënësit shikojnë shembuj të veprave të artistëve të famshëm (p.sh. Klod Mone, Van Gog, Xheorxhija O'Kif, etj.) dhe identifikojnë harmoninë e ngjyrave në to.
- Nxënësit vizatojnë elemente të florës duke përdorur harmoninë e ngjyrave, me ngjyra uji ose tempera.
- Nxënësit shikojnë shembuj të veprave të artistëve të famshëm (p.sh. Van Gog, Gogen, Matis, Klod Mone, Liçenoski) dhe vënë re dhe dallojnë kontrastin e ngjyrave nga harmonia e ngjyrave.
- Nxënësit vizatojnë një kompozim duke përdorur kontrast ngjyrash plotësuese (kuqe-gjelbër, e kaltër-portokalltë ose vjollcë-verdhë) me një motiv portret/autoportret, sipas shembullit të Endi Vorhol, duke përdorur programe kompjuterike grafike.
- Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, krijojnë një kompozim figurativ të motiveve nga flora dhe fauna me teknikën e kolazhit (copa kartoni, lloje të ndryshme letre, tekstile etj.).
- Nxënësit vizatojnë një kompozim jofigurativ me forma abstrakte të imagjinatës së tyre në një teknikë të zgjedhur nga nxënësi (duke ndjekur shembuj nga Wassily Kandinsky, Jackson Pollock, Petar Mazev etj.). Më pas, nxënësit shfaqin krijimet e tyre dhe ua prezantojnë shokëve të klasës, duke interpretuar kuptimin/simbolizmin e tyre.
- Nxënësit shikojnë shembuj të punimeve grafike dhe krijojnë një vizatim-skicë për grafikë (teknika e gipsit) me tone akromatike dhe/ose kontrast dritë-errësim mbi një temë të caktuar Peizazh ose natyrë e vdekur.
- Nxënësit krijojnë grafikë në një ose dy tone në teknikën e gipsit. Për secilin ton, nxënësi duhet të bëjë një bazë/matricë të veçantë grafike. Ngjyrë në tonin e dëshiruar aplikohet në matricat e përgatitura me një vegël për të ngjeshur. Printimi bëhet sipas radhës (në fillim toni më i lehtë, pastaj toni më i errët) sipas vizatimit të bërë më parë.
- Nxënësit krijojnë një matricë printimi duke përdorur teknikën e kolazhit. Materialet me tekstura të ndryshme (fije, leshi, gravure në dru, pëlhura, gjethe, letra me tekstura të ndryshme, pupla, zumpare, rërë, etj.) Ngjiten në një bazë plastike ose kartoni për të marrë një kompozim të përbërë nga vija dhe tekstura të ndryshme të theksuara. Ngjyrë aplikohet në sipërfaqen/matricën që rezulton me një mjet rrafshues apo trup cilindrik, i cili më pas shtypet në letër (vulë të lartë), duke theksuar format me teksturë dhe kontrast.

- Nxënësit mund të printojnë matricën e kolazhit duke aplikuar ngjyra të kundërta (njëra ngjyrë aplikohet me rakel - për vulë të thellë, dhe ngjyra e dytë me mjetin rrafshues - për vulë të lartë), dhe më pas realizojnë gjurmë grafike në vulë të lartë dhe të thellë në të njëjtën kohë, por në letër të lagur.
- Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, shikojnë produkte të ndryshme të dizajnit grafik dhe i klasifikojnë ato në: dizajn librash (kopertina, ilustrim), fletushka dhe banderolë . Më pas, prej tyre krijojnë diagrame/postera edukative që i vendosin në klasë dhe i prezantojnë
- Nxënësit shikojnë shembuj të ornamenteve nga e kaluara (në artin popullor: të endura dhe të qëndisura, në qeramikë, etj.), vërejnë ritmin e formave të stilizuara dhe i zbatojnë në mënyrë krijuese në punimin e tyre mbi motivin: Veshje popullore nga treva ime.
- • Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, krijojnë një kopertinë dhe ilustrim për një libër sipas zgjedhjes së tyre (poezi, prozë) duke përdorur teknikat e vizatimit dhe pikturës dhe kombinimet e tyre, duke kombinuar vija, forma, ngjyra dhe ornamente. Më pas secili grup/dyshe prezanton idenë e tij para shokëve të klasës, duke e lidhur me një fragment të veprës letrare të zgjedhur.
- Nxënësit krijojnë një zgjidhje ideore me një kombinim të vizatimit dhe tekstit për fletushka/ banderole me motiv: Shkollë sipas përmasës sime. Ata printojnë zgjidhjen ideore dhe ua prezantojnë atë shokëve të klasës, duke interpretuar mesazhin vizual dhe tekstual që e kumtojnë përmes këtyre produkteve.

Tema: **ARTI TREDIMENSIONAL**

Orët e përgjithshme: 8

### Rezultatet e mësimit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të dallojë format tredimensionale të formimit të plastikës në hapësirë dhe të zbatojë teknika dhe procedura të ndryshme skulpturore;
2. të njohë nevojën për dizajn bizhuterish dhe paketimi, të aplikojë forma të stilizuara, të krijojë një zgjidhje ideore për dizajnin e bizhuterive dhe të përdorë programe kompjuterike grafike për dizajnin e paketimit.

Nxënësi/nxënësja do të:

1. zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin gjatë krijimit të veprave artistike;
2. zhvillon aftësitë manuale;
3. zhvillon aftësinë për vlerësimin estetik të veprave artistike dhe të krijimeve të nxënësve.

### Përmbajtjet (dhe nocionet):

- **Formësimi plastik**

### Standardet e Vlerësimit:

- Të dallojë skulpturën e galerisë, skulpturën në miniaturë dhe atë monumentale.

<p>(skulpturë, skulpturë e galerisë, miniatyrë, skulpturë monumentale, sapun, dyllë, hapësirë, kontrast, harmoni)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbaton teknikën e gdhendjes kur bën një miniatyrë sapuni/ dyllë.</li> <li>• Identifikon kontrastin dhe harmoninë e madhësive dhe formave në një vepër tredimensionale.</li> <li>• Zbaton formësimin me karton gjatë realizimit të një skulpture.</li> <li>• Kompon skulpturë komplekse në hapësirë nga materiale të shumta.</li> <li>• Interpretin kuptimin/simbolizmin e skulpturës së realizuar.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Dizajn dhe komunikime vizuale në 3D</b> (dizajn bizhuterish, produkt serie, unik, ritëm, stilizim, filigran, ambalazhim, Quiling (Kviling))</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh një produkt nga fusha e dizajnit të bizhuterive.</li> <li>• Aplikon forma të stilizuara gjatë dizajnit të bizhuterive.</li> <li>• Krijon një zgjidhje ideore për filigranin në teknikën Quiling (Kviling).</li> <li>• Përdor programe kompjuterike grafike për të krijuar zgjidhje ideore për dizajnin e paketimit.</li> </ul>

### Shembuj aktivitetesh

- Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, duke përdorur internetin, shikojnë shembuj të skulpturave të ndryshme dhe bëjnë dallimin midis skulpturës së galerisë, miniatyrës dhe skulpturës monumentale.
- Nxënësit bëjnë miniatyrë me motivin e figurës njerëzore duke gdhendur në sapun /dyllë.
- Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, vëzhgojnë vepra artistike tredimensionale dhe objekte nga mjedisi, identifikojnë kontrastin dhe harmoninë e madhësive dhe formave dhe ua prezantojnë njohuritë të tjerëve.
- Nxënësit bëjnë skulptura me forma kafshësh nga kartoni duke ndjekur shembullin e skulpturave të Aleksander Kalder (me forma kafshësh) dhe më pas i lyejnë me ngjyra tempera.
- Nxënësit, të ndarë në grupe të mëdha, krijojnë një skulpturë me tela dhe duke kombinuar materiale të tjera (fletë alumini, kartonë, pëlhura etj.) me motivin e zgjedhjes së tyre. Nxënësit ekspozojnë krijimet e tyre dhe ua prezantojnë shokëve të klasës, duke interpretuar kuptimin/simbolizmin e tyre.
- Nxënësit, të ndarë në grupe/dyshe të vogla, përdorin internetin për të hulumtuar temën e bizhuterive dikur dhe tani (historia, veçantia dhe prodhimi serik) dhe shikojnë shembuj të ndryshëm të bizhuterive. Më pas, shembujt i printojnë dhe krijojnë diagrame/postera edukative që i vendosin në klasë dhe i prezantojnë.
- Nxënësit diskutojnë për nevojën e krijimit të bizhuterive në teknikën e filigranit. Më pas krijojnë një zgjidhje ideore për bizhuteritë (vathë, varëse, unazë, byzlyk, brosh, etj.) duke përdorur laps, tush etj.
- Nxënësit realizojnë një vepër në teknikën Quiling (Kviling) me motivin: Bizhuteria ime e vetme me filigran.
- Nxënësit krijojnë një skicë (zgjidhje konceptuale) për dizajnimin e ambalazhit: Një kuti bizhuterish, sipas idesë së tyre me ndihmën e programeve kompjuterike grafike. Ata ua prezantojnë zgjidhjen ideore shokëve të klasës duke përshkruar dhe shpjeguar idenë dhe përdorimin e sendit/ambalazhit të imagjinuar të bizhuterive.

## GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA/NDJESHMËRIA GJINORE, NDËRKULTURALITETI DHE INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirje/inkluzivitet duke i përfshirë të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës së mësimi. Në të njëjtën kohë, ai i mundëson secilit fëmijë të angazhohet në mënyrë kognitive dhe emocionale përmes përdorimit të qasjeve të përshtatshme metodike (individualizimi, diferencimi, puna në grup, mbështetja e shokëve të klasës). Kur punon me nxënës me aftësi të kufizuara, ai zbaton një plan edukativ individual (me rezultate të përshtatshme e të nxënës dhe standarde vlerësimi) dhe sa herë që është e mundur përdor mbështetje shtesë nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetës edukativë, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat me qendër burimore.). Ai monitoron rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e ndjeshme, në mënyrë që të mund të identifikojë menjëherë vështirësitë e të nxënës, t'i inkurajojë dhe mbështesë ata në arritjen e rezultateve e të nxënës.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësuesi/ja trajton njëloj si djemtë ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u caktojë role të stereotipizuara gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, ai përpiqet të sigurojë një ekuilibër në aspektin gjinor. Kur zgjedh materiale shtesë mësimore, ai përdor ilustrime dhe shembuj që janë të ndjeshëm gjinor dhe etnik/kulturor dhe inkurajojnë barazinë gjinore, domethënë promovojnë ndërkulturalizmin.

Kur është e mundur, mësimdhënësi/ja përdor integrimin e temave/përmbajtjeve/koncepteve në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies. Integrimi i lejon nxënësit të përfshijnë këndvështrimet e lëndëve të tjera në atë që mësojnë në këtë lëndë dhe të lidhin njohuritë nga fusha të ndryshme në një tërësi.

## VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Për t'i mundësuar nxënësve arritjen e standardeve të pritura të vlerësimit, mësimdhënësi monitoron vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe mbledh informacion për përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin komente kthyesë që tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe japin drejtime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim mësimdhënësi i monitoron dhe i vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose shokët e klasës;
- aktivitetet kërkimore gjatë të cilave nxënësi vëzhgon, prezanton rezultatet dhe i paraqet ato;
- performancën praktike dhe aktivitetin e orëve gjatë prodhimit të punimeve të veta dhe të përbashkëta;
- krijimet (vizatime, fotografi, grafika, skulptura, dizajnë, ilustrime, prezantime, modele, etj.);
- vlerësimin estetik të veprave artistike dhe të krijimeve të nxënësve;
- përgjigjet e kuizeve (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies.

Pas përfundimit të mësimit të çdo teme, nxënësi merr një notë përmbledhëse numerike të standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi përmbledhës numerik kryhet si një kombinim i rezultatit të arritur në aktivitetet krijuese praktike dhe pjesës teorike - përmes përgjigjeve me gojë dhe testit të njohurive të gjuhës së artit në kombinim me vlerësimin e përparimit të konstatuar përmes teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësues</b>	Viti shkollor 2025/2026
<b>Institucioni/ bartës i programit</b>	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
<b>Në bazë të nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për Arsimin Fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësues për lëndën <i>Arsimi figurativ</i> për klasën VII.</b>	nr. 12-12122/2 8.11.2023  Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Doc. Dr. Jeton Shaqiri, d.v.  _____